



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

V E N D I M

Nr. 162, Datë 09/09/2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”¹, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 141, datë 29.07.2021, e z. B.H., ku pretendohet diskriminim, nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Dega Rajonale Vlorë.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri²,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban ankesa, rezulton se ankuesi B.H., i lindur në datën 02.02.1955, pas plotësimit të moshës përkatëse, ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm, të cilin e ka depozituar pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Dega Rajonale Vlorë, për të përfituar pension pleqërie.

Ankuesi thekson faktin se për dy periudha të ndryshme kohore dhe në mënyrë të shkëputur ka punuar si shofer zjarrëfikës, përkatësisht pranë Prefekturës Vlorë përgjatë periudhës 2002-2012 dhe pranë Portit Detar Vlorë për periudhën 2014-2020. Për periudhën e parë, kur z. B.H. ka punuar si shofer zjarrëfikës pranë Prefekturës Vlorë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega Rajonale Vlorë, në përlllogaritjet e kryera, krahas viteve të punës i ka shtuar edhe përfitimin e statusit si punonjës zjarrëfikës, ndërkohë që për periudhën e dytë, kur ai ka kryer të njëjtën detyrë pranë Portit Detar Vlorë, ky institucion nuk i ka njohur statusin e punonjësit zjarrëfikës dhe nuk i ka shtuar vleftën përkatëse të këtij përfitimi në pensionin e pleqërisë.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Ankuesi shprehet se nuk është dakord me përlllogaritjen e kryer nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega Rajonale Vlorë, pasi pozicioni i punës ka qenë i njëjtë në të dy rastet dhe këtë trajtim të diferencuar e konsideron diskriminim ndaj tij.

Në këtë kontekst, ankuesi kërkon nga KMD konstatimin e diskriminimit nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Dega Rajonale Vlorë, për caktimin e pensionit të pleqërisë për periudhën 20.10.2014-31.01.2020, si dhe t'i njihet statusi si punonjës zjarrëfikës dhe t'i rillogaritët pensioni nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega Rajonale Vlorë, sipas kësaj kategorie për periudhën e sipërcituar.

A. Procedurat e ndjekura nga Komisioneri.

Pas analizimit fillestar të ankesës, Komisioneri iu drejtua ankuesit nëpërmjet shkresës nr. 1124/2 prot., datë 02.08.2021, ku i kërkohet informacion plotësues dhe përkatësisht identifikimi i saktë i shkakut të diskriminimit të pretenduar.

Në shkresën e sipërpërmendur citohet shprehimisht: *“Pas analizimit paraparak të ankesës, Komisioneri konstatoi se ju nuk keni përcaktuar shkakun e diskriminimit të pretenduar. Shkaku i diskriminimit konsiston në një karakteristikë personale të ankuesit, si pasojë e së cilit ai ekspozohet ndaj një qendrimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e subjektit diskriminues. Neni 1, i LMD parashikon mbrojtjen nga diskriminimi, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.” Për sa më sipër, lutemi të përcaktohet shkakun e diskriminimit të pretenduar, i cili duhet të jetë i mbështetur në prova dhe fakte konkrete. Njëkohësisht, lutemi të jepen shpjegime mbi lidhjen shkakësore ndërmjet shkakut të diskriminimit dhe trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë ndaj së cilit jeni ekspozuar nga ana e subjektit diskriminues.”*

- Në përgjigje të shkresës nr. 1124/2 prot., datë 02.08.2021, së KMD-së, ankuesi dërgoi informacionin e datës 13.08.2021, ku jep edhe një herë parashtrimet e dhëna në ankesë, pa përcaktuar shkakun e saktë të diskriminimit, por duke u shprehur se shkakun e diskriminimit të pretenduar të përfshihet nën opsionin *“për çdo shkak tjetër”*.

- Në këto kushte, kur shkak i diskriminimit nuk ishte saktësisht i identifikuar nga ankuesi, Komisioneri u mundua të kontaktonte në datën 01.09.2021, me ankuesin nëpërmjet telefonit³, për t'i sqaruar se pavarësisht se përzgjedhja e tij mbi këtë shkak ishte opsioni “*për çdo shkak tjetër*”, ai duhet sërish ta përcaktonte dhe provonte këtë shkak. Kontaktimi me ankuesin në numrin celular të shënuar në ankesë nuk u arrit të kryhej, pavarësisht se përfaqësuesit e KMD-së tentuan disa herë të realizonin lidhjen.

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:

Ligji nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, ku ndër të tjera përmendet edhe opsioni “*për çdo shkak tjetër*”. Ky nen përcakton se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Opsioni “*për çdo shkak tjetër*” i përcaktuar më sipër, nënkupton që shkak i diskriminimit nuk është asnjë prej shkaqeve që bëjnë pjesë në listën e sipërcituar, por është një shkak tjetër që duhet të përcaktohet nga vetë nga personi, i cili pretendon diskriminim.

Neni 3, i ligjit nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 20, pikat 1, gërma a), të LMD, të ndryshuar, parashikohet se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;”

³ Për efekt të komunikimit të shpejtë dhe efikas me ankuesit, KMD komunikon nëpërmjet emailit zyrtar me ta. Në kushtet kur, z. B.H. nuk ka shënuar adresë e-maili në ankesë, KMD u mundua të kontaktonte nëpërmjet numrit celular të shënuar nga ana e tij në ankesë.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, të ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave, Komisioneri ndjek procedurën ligjore, të parashikuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar. Gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri evidenton së pari, nëse ankuesi është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e subjektit kundër së cilit drejtohet ankesa.

Në vijim të ndjekjes së procedurave ligjore, Komisioneri reflekton mbi vlefshmërinë ligjore dhe të provuar, të shkakut të diskriminimit. Në përfundim, vërteton duke analizuar provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, nëse ka lidhje shkakësore ndërmjet qendrimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë ndaj së cilit ankuesi është ekspozuar, me shkakun e diskriminimit të pretenduar.

Për sa më sipër, shkakun e diskriminimit përbën një element kyç në hetimin administrativ të Komisionerit, si dhe duhet vërtetuar me prova të mbështetura në fakte konkrete. Shkakun e diskriminimit në vetëvete lidhet me një karakteristikë personale të ankuesit, e cila përbën pikënisje për reagimin e padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë subjektit ndaj tij.

Ankuesi ka vënë në dukje se është diskriminuar “*për çdo shkak tjetër*”, pa përcaktuar se cili është ky shkak, pra pa e identifikuar dhe provuar shkresërisht këtë shkak. Si rrjedhim, Komisioneri gjykon se përzgjedhja e opsionit “*për çdo shkak tjetër*” nuk përbën në vetvehte shkak të vlefshëm, ligjor, për diskriminimin e pretenduar nga ankuesi, pasi ky shkak duhet identifikuar dhe faktuar ligjërisht.

Në nenin 33, pika 4, gërma ç), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, parashikohet se nuk pranohen ato ankesa kur: “*është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim*”.

Për sa më sipër, KMD gjykon se ankesa e z. B.H. nuk pranohet për shqyrtim, pasi është e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 4, pika 1, nenin 7, pika 3, nenin 5, pika 1, nenin 20, pika 1, gërma a) nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 141, datë 29.07.2021, së z. B.H., pasi është haptazi e pabazuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkak - për çdo shkak tjetër
Fusha – të mira dhe shërbime
Lloji i vendimit - mospranim